

Njoftim për Shtyp

Duke marrë shkas nga shkrimi i sotëm në gazetën Shqip lidhur me ndërprerjen e energjisë elektrike, fabrikës së miellit “Mulliri i artë” në Fier, si dhe akuzave të përsëritura të cilat artikulli, duke cituar pronarin e fabrikës në fjalë, ngre kundrejt Entit Regullator të Energjisë dhe Kryetarit të saj, Z. Ahmeti, jemi të detyruar, në këto kohë të vështira, të sqarojmë opinionin publik për sa më poshtë vijon:

Në zbatim të nenit 87, pika 4 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ERE ka miratuar “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, në Dhjetor të vitit 2017.

Ligji i sektorit, përcakton se Klientët e lidhur në tensionin 35 kV, siç mund të jetë rasti i fabrikës në fjalë, janë të lirë për të gjetur furnizim në treg të lirë ose, mund të furnizohen nga ana e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit. Biznesi në fjalë, fabrika e miellit duke qenë se siç shprehet në shkrim, furnizohet në tensionin 35 kV, bën pjesë në këtë kategori klientësh. Është në zgjedhjen e klientit, biznesit në fjalë, mënyra e furnizimit, dhe ky i fundit ka zgjedhur me dëshirën e vetë të furnizohet nëpërmjet Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, me çmime të cilat megjithëse miratohen nga ERE, janë të rregulluara nga vetë tregu dhe përfshijnë kostot e importit, tarifën e transmetimit dhe shpërndarjes si dhe kostot administrative të ketij të fundit.

Në këtë përlllogaritje, kostot si, tarifa e transmetimit, e shpërndarjes si dhe kostot administrative janë kosto të pandryshueshme, ndërkohë që kosto e importit është variable dhe varet nga tregjet e importit, ndaj dhe çmimi është i ndryshëm nga muaji në muaj.

Si rrjedhojë përgjatë vitit 2019, ky çmim ka variuar nga 12.75 lekë/kWh për muajin Korrik dhe Gusht, 14.68 dhe 16.75 lekë/kWh për muajt Nëntor dhe Dhjetor, lidhur kjo veçanërisht me kostot e importit në tregjet e energjisë elektrike, ku çmimi i importit për muajt Korrik e Gusht ka qenë rreth 63 Euro/MWh ndërsa për muajt Nëntor dhe Dhjetor ka qenë përkatësisht në vlerat rreth 84 dhe 100 Euro/MWh.

Për të qartësuar më tej opinionin publik, duhet theksuar se ERE nuk faturon energjinë elektrike të klientëve pasi është përtej kompetencave të veta si institucion, nëse klientët, përfshirë këtu dhe biznesi në fjalë, kanë pretendime, ato kanë të gjitha mundësitë për të ankimuar çdo vendimmarrje të ERE-s apo dhe faturimin për to. Po ashtu shkrimi aludon se ERE miraton çmime të veçanta për prodhues të ndryshëm, fakt që nuk është i vertetë pasi, ERE miraton çmime për kategori klientësh, është në përgjegjësinë e furnizuesit të caktojë cilës kategori i përkasin klientët, dhe në bazë të saj të përpilojë faturën dhe të përcaktojë nëse i takon kategorisë të cilët faturohen me tarifën 7.1 Lek/kWh apo me tarifën e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

Sqarojmë, se hapja e tregut të energjisë elektrike për të gjithë klientët e sektorit përveçse është një angazhim i përcaktuar qysh në vitin 2015 nga ana e Qeverisë Shqiptare nëpërmjet miratimit të ligjit të sektorit, në kuadër të detyrimeve ndërkombëtare për krijimin e tregut të përbashkët Evropian por në radhë të parë është edhe një mundësi dhe oportunitet që i jepet klientëve për të gjetur furnizues në treg

të lirë me çmime të cilat mund të konkurojnë shoqëritë publike në vend apo dhe jashtë vendit duke mundësuar nëpërmjet konkurimit uljen e kostove të energjisë elektrike për këdo klient dhe ERE është e angazhuar maksimalisht për të mundësuar me çdo kusht zbatimin e këtij procesi në mënyrë transparente dhe të drejtë si dhe mbrojtjes së të drejtave të çdo klienti nga çdo abuzim i mundshëm.

Përsa i takon ndërprerjes së energjisë elektrike nga ana e OSHEE-së për klientin në fjalë, ERE, në zbatim dhe të masave të fundit të ndërmarra nga ana e Qeverisë Shqiptare me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019, është duke ndjekur me seriozitet situatën në fjalë, për qartësimin e saj brenda kuadrit ligjor në fuqi.